



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:040953

Datë: 23.01.2024

Numri i dokumentit: 05227231

C.nr.796/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H. A. nga Fushë Kosova dhe M. S. nga Fushë Kosova, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit avokati F,G. nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Fushë Kosovës - Drejtoria për Shëndetësi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hasime Qyqalla, juriste tek e paditura, me objekt kontesti pagesa e shpërblimit jubilar, jashtë seancës, me datë 23.01.2024 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H. A. nga Fushë Kosova dhe M. S. nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, që paditëses H. A. në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t’ia paguajë shumën në vlerë të një page bazë në lartësi prej 314 euro, si dhe paditësit M. S. në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, t’ia paguajë në vlerë të dy pagave bazë shumën prej 628 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 03.03.2021 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësve t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 176.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetimi

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 03.03.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, për pagesën e shpërblimit jubilar, me kamatë ligjore. Paditësit padinë e tyre e kanë ndryshuar në aspektin objektiv me parashtresën e datës 22.12.2023.

Në padi dhe në parashtresën për ndryshimin e padisë kanë theksuar se që të dy paditësit janë të punësuar në QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë, ku paditësja H. A. tashmë ka 14 vite përvojë pune, dhe paditësi M. S. tashmë ka 22 vite përvojë pune. Më tutje kanë theksuar se paditësit sipas listës së pagave pagat bazë i kanë nga 314 euro, dhe atyre u takon kompensimi në emër të shpërblimit jubilar, dhe atë paditëses H. në vlerë të një page bazë në lartësi prej 314 euro,

ndërsa paditësit M. në vlerë të dy pagave bazë nga 314 euro, e gjithsej për paditësin M. në lartësi prej 628 euro.

Shpenzimet i kanë kërkuar, dhe atë 156 euro për përpilimin e padisë, 156 euro për përpilimin e parashtrësës për ndryshimin e padisë dhe 20 euro për taksë gjyqësore.

E paditura, me datë 13.07.2021 ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, ngase sipas saj paditësit nuk e kanë shterur paraprakisht organin administrativ. Sipas të paditurës kjo kërkesë duhej të ishte vendosur në procedurë administrative, që të mos shkaktohen shpenzime nga paraja publike. Ka shtuar se sipas nenit 124, pika 6 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative është me prioritet procedura administrative, andaj ka kërkuar nga gjykata që padinë ta kthen në procedurë administrative.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe të përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, po ashtu gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, andaj pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret rezulton se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë, në pozitën e punës paditësja H. si higjeniste, dhe paditësi M. si pastrues. Këtë fakt, edhe pse nuk ishin kontestuar nga e paditura, gjykata e vërtetoi nga kontratat e punës së paditësve të lidhura me të paditurën.

Gjykata konstaton se për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se paditësja H. në qershor të vitit 2021 i ka pasur 12 vite përvojë pune, që i bie se në vitin 2019 e njëjta i ka pasur 10 vite përvojë pune, ndërsa paditësi M. në qershor të vitit 2021 i ka pasur 20 vite përvojë pune, dhe se paga bazë e tyre ka qenë 314 euro. Edhe ky fakt nuk ishte kontestuar nga e paditura, por megjithatë gjykata e ka vërtetuar edhe nga listat e pagave për dy paditësit, të muajit qershor 2021 dhe vërtetimet mbi përvojën e punës së paditësve.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte vetëm procedura që paditësit duhej ndjekur për ta realizuar kërkesën e tyre.

Në rastin konkret lidhur me bazën e kërkesëpadisë gjykata vlerëson se duhet të zbatohet Kontrata Kolektive Sektoriale, e lidhur me datë 11.06.2018, dhe e nënshkruar nga Organizata e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Shëndetësisë) (në vijim KKS), e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018, e deri më 10.06.2021.

Me nenin 4, paragrafi 1, pika 1. të KKS-së, parashihet që *”KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”*, dhe paragrafi 2 *“Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”*.

Gjithashtu, me nenin 17, paragrafi 3 të KKS-së parashihet se “*punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij*”. Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se “*Punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadsisë së paditësve, gjykata u bazua në listat e pagave në emër të paditësve, si dhe në vërtetimet mbi përvojën e punës së paditësve, ku nga listat e pagave u konstatua se të njëjtit pagën bazë e kanë në lartësi prej 314 eurove, ndërsa nga listat e pagave dhe vërtetimet e përvojës së punës u vërtetua se paditësja H. i ka 10 vite përvojë pune, e kështu asaj i takon shpërblimi jubilar në vlerë të një page, ndërsa paditësi M. i ka 20 vite përvojë pune 20 vite përvojë pune, dhe kështu atij i takon kompensimi në vlerë të dy pagave bazë nga 314 euro, përkatësisht shuma prej 628 euro, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës të parashtruara në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për vendosje ndryshe, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me kompensim në të holla në emër të shpërblimit jubilar nga marrëdhënia e punës së paditësve si punëtorë të shëndetësisë, dhe nuk është e nevojshme që për këto kërkesa para se të paraqitet padia të shteret ndonjë mjet i brendshëm tek punëdhënësi, apo që paditësit t’i drejtohen Inspektoratit të Punës për realizimin e kësaj kërkesë. Në këtë rast, përkatësisht për këto kërkesa nuk zbatohet neni 124, paragrafi 6 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, siç pretendon e paditura, pasi që ky nen ka të bëjë me ankesat në procedurë administrative, për të cilat duhet të shteren mjetet juridike të brendshme para se të hapet konflikti administrativ.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe e njëjta do të llogaritet në shumën e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 176.00 €, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 156 euro, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore. Ndërsa, gjykata nuk e detyroi të paditurën që paditësve t’ua paguajë edhe shumën prej 156 euro në emër të parashtrësës për ndryshimin objektiv të padisë, pasi që paditësit me fajin e tyre nuk e kanë paraqitur padinë të rregulluar që nga fillimi.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.796/21, datë 23.01.2024

Gjyqtari

Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.